



MESAZHI I KRYETARIT TË KISHËS PROTESTANTE UNGJILLORE TË KOSOVËS PASTOR DRITON KRASNIQI

Krishtlindja – ditë e paqes, pajtimit dhe shpresës për shpëtimin

Prishtinë, më, 22.12.2014

Të dashur vëllezër e motra,
Të dashur qytetarë dhe qytetare të Republikës së Kosovës,

Edhe një herë bashkë me ju po e rrumbullakojmë një vit. Ka qenë ky një vit i suksesit por edhe i sfidave të mëdha si në rrafshin personal të njerëzve ashtu edhe në atë kombëtar. Ndërkohë që korporatat e shfrytëzojnë fundvitin për të bërë bilancet e tyre, besoj se është e drejtë që çdo burrë e grua t'i bëjë përllogaritjet e veta jetësore.

Këtë vit Kosova ka mbajtur zgjedhje të suksesshme ndërkohë, me mund të madh janë krijuar institucionet shtetërore e ekonomia e vendit nuk u ringjall. Janë zhvilluar shumë takime ndërmjet bashkësive fetare në vend por kërkesat e komunitetit tonë për sigurimin e hapësirës për kisha dhe lokacionet për varreza, kanë ngelur larg përmbushjes. Gjatë këtij viti mijëra njerëz, duke përfshirë edhe gratë e fëmijët, kanë imigruar në shtetet Perëndimore në kërkim të shpresës jetësore. Nga skena botërore përmes ekraneve televizive janë transmetuar pamje të trishtuara të mizorive kundër njerëzve të pafajshëm – pamje këto që kanë tmerruar çdo njeri të vullnetit të mirë.

Por, derisa përshkruajmë të gjitha këto zhvillime, duhet ta zgjojmë njohjen për të parë se Perëndia në asnjë rast nuk na ka harruar, as si individë e as si komb. Në këtë kohë Krishtlindje, na bëhet i gjallë Lajmi i Mirë i Fjalës së Perëndisë i kumtuar përmes engjëjve rreth 2,000 vite më parë: “...Sot, në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti” (Lluka 2:11).

Që nga koha e pas luftës, në Kosovë është ndërtuar traditë që në vigjilje të Krishtlindjes të dekorohet qyteti. Në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë stoliset pema e Krishtlindjes dhe bëhet ndezja e dritave. Këtë vit kjo kishte gjasa të mos ndodhte gjë që ka shkaktuar zemërim tek shumë njerëz.

Sidoqoftë situata, ngjarja vetë duhet të nxis të menduar tek ne se çfarë saktësisht e bën Krishtlindjen festë kaq të rëndësishme?

Vëllezër e motra,

Dekorimet prodhojnë atmosferë festive dhe nuk ka asgjë të keqe me këtë. Por, pavarësisht sa të bukura janë ato; sa të magjishme janë dritat shumë ngjyrëshe e sa mbresëlënëse është glamuri, Krishtlindja mbetet Krishtlindje edhe pa to. Megjithatë, ka një gjë pa të cilën Krishtlindja është e pa kuptimtë. Pa protagonistin, Krishtin, dhe pa lajmin e gëzuar për lindjen e tij si Shpëtimtar, Krishtlindja nuk ka asnjë vlerë.

Krishtlindja është datë e shënuar në historinë e njerëzimit sepse ideatori i Krishtlindjes është vetë Krijuesi i njerëzimit. Kur lind një foshnje, ne asnjëherë nuk mund ta prejudikojmë jetën e foshnjës. Askush nuk mund të thotë nëse do të bëhet luftëtar i të drejtave njerëzore si Nelson Mandela apo vrasës si Adolf Hitleri. Lindja e Jezus Krishtit dallon. Vet lindja e tij ishte e mbinatyrshme por atë e bën të veçantë edhe fakti se nga dita e parë e lindjes së tij, engjëjt paratregojnë për misionin e jetës së tij prej Shpëtimtari.

Engjëlli i Zotit paralajmëroi njerëzimin mbarë se kjo foshnjë në fakt kishte lindur për ta dhe se ai vetë është Shpëtimtari, Mesia, Krishti. Kjo e bën porosinë e lashtë të Krishtlindjes një lajm universal dhe relevant për sot.

Shpëtimtari ka lindur për të falur mëkatin; për të çliruar jetën nga errësira; për të sjellur qetësi shprese në mes të stuhive jetësore; për të sjellur fitoren mbi djallin – armikun e shpirtrave tonë.

Në Krishtlindje mësojmë se

- Perëndia i pa fillim as mbarim, pranon të mishërohet në njeri;
- Perëndia i përsosur zgjedh të rritet si njeri nga ne por duke mos mëkatuar kurrë;
- Perëndia i përjetshëm dhe i pavdekshëm i nënshtrohet vdekjes së kryqit;

Jezusi ka lindur për secilin prej nesh. Fjala e Zotit na mëson se të gjithë njerëzit “...mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë” (Romakëve 3:23).

Në grazhdin e Krishtlindjes lind mesazhi i paqes e pajtimit; i dashurisë e faljes së Zotit për çdo njeri pa dallim kombi, feje, race a bindje. Jezus Krishti nuk është Zot që mban anë, ai ka ardhur për çdo njeri. Pavarësisht si besojmë ose nuk besojmë fare, Jezusi ka lindur për të të falur dhe shpëtuar. Jezusi është i butë e i mirë. Ai dhe ndjekësit e tij, asnjëherë nuk e përdorin forcën për ta detyruar ndonjë njeri për ta pranuar një fe të caktuar. Shpresa e njeriut nuk ndodhet tek feja, por tek Zoti!

Sikur asnjë njeri tjetër në histori, jeta dhe mësimi i Jezus Krishtit janë shembull për çdo brez duke influencuar jetët e njerëzve. Jeta e tij plot dhembshuri e vetëmohim për të tjerët, mësimi i tij u bë zëri i fuqishëm për 2 mileniume. Besimtarët tonë, duke ndjekur shembullin e mirësisë së Jezus Krishtit kanë ndihmuar qindra familje në të gjitha trevat e Kosovës. Në këtë kohë Krishtlindje kishat tona po shpërndajnë rreth 31,000 dhurata të Krishtlindjes duke sjellur buzëqeshje në jetët e fëmijëve tonë. Duke dhuruar dhurata falas ne përçojmë mesazhin e Fjalës së Zotit se Shpëtimtari dhe shpëtimi janë falas për atë që e pranon, por i ka kushtuar atij që e ka përgatitur. Jam shumë krenar me shërbesën e çdo besimtarit të çdo kishe në Kosovë për popullin tonë.

Më 24 dhjetor 32 kishat tona në 17 komuna të Kosovës do të bashkohen në shërbesa speciale të Krishtlindjes. Jemi të bekuar që sikur edhe viteve tjera, edhe këtë vit, të mirëpresim qindra njerëz në shërbesat tona të Krishtlindjes.

Në përmbyllje, më lejoni që në emër të anëtarësisë së gjerë të kishave protestante ungjillore të Kosovës t’ju uroj të gjithëve – **GËZUAR KRISHLINDJA!** Ju uroj që të kemi një festë të bekuar; që paqja e Perëndisë të jetë me ju dhe që ndriçimi i tij të përshkojë zemrën dhe mendjen tuaj.